



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Asfalto beton e bitum per sperkatje”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Bitum dhe asfalt **(44113600-1)**

VLERA E FONDIT LIMIT: 25,000,000 (njëzet e pesë milion) lekë PA TVSH.

Autoriteti kontraktor ka llogaritur fondin limit duke marre çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë autoriteti ne perputhje me parashikimet ligjore te nenit 76, paragrafi I (pare) pika c) ,të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Ndermarrja e Sherbimeve Publike, Bashkia Korçe** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare: **2020, 2021,2022** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vleres te parashikuar te kontrates.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 paragrafi 2 pika b), tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros te jete jo më e vogel se vlera e fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2b te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes te njoftimit te kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.1 Disponimi i mjeteve te meposhtme:

Lloji i Makinerive	Sasia	PRONESIA
Mjet Transporti , kamion jo me pak se 3.5 ton	cope 1	Ne pronesi ose me qera
Mjet Transporti , kamion jo me pak se 10 ton	cope 1	Ne pronesi ose me qera

Fabrike asfaltobetonit	cope 1	Ne pronesi, me qera ose kontrate furnizimi te nenshkruar para noterit, per furnizimin.
------------------------	--------	--

Per mjetet e transportit

- ***Kur mjetet jane ne pronesi duhet te paraqitet:*** dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e pronesise, certifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit.
- ***Kur mjetet jane me qera duhet te paraqitet :*** kontrata e qerese e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, e shoqeruar me lejen e qarkullimit, certifikaten e pronesise, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit.

Per Fabriken e Asfaltobetonit

- ***Ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqiten:*** dokumente qe vertetojne pronesine (duhet te paraqitet certifikate pronesie, planvendosje dhe/ose fature tatimore dhe/ose fature zhdoganimi) dhe leja mjedisore (duhet te paraqitet leja mjedisore Kodi III.1B leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit ose leja mjedisore te leshuar nga Ministria e Mjedisit.)
- ***Kur Fabriken e Asfaltobetonit eshte me qera duhet te paraqitet:*** Kontrata e qerese e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi e shoqeruar me dokumente qe vertetojne pronesine (duhet te paraqitet certifikate pronesie, planvendosje dhe/ose fature tatimore dhe/ose fature zhdoganimi) dhe lejen mjedisore (duhet te paraqitet leja mjedisore Kodi III.1B leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit ose leja mjedisore te leshuar nga Ministria e Mjedisit.)
- ***Ne rast se nuk eshte ne pronesi apo me qera:*** duhet te paraqitet kontrata e furnizimit nenshkruar para noterit me prodhuesin ku te jete i percaktuar :
 - a. furnizimi i vazhdueshem dhe sipas kerkeses ,
 - b. sasia dhe afati i perfundimit te kontrates.

2.3.2 Deshmi per fuqine mesatare puntore te operatorit ekonomik :

Nje punesim mestar prej te pakten **2 (dy)** shofere, per periudhen **dhjetor 2022-shkurt 2023** e dokumentuar kjo me vertetimin e kontributeve te sigurimeve shoqerore e shëndetësore leshuar nga Administrata tatimore

Per shoferet duhet të paraqitet

- Certifikatën e aftësisë profesionale të lëshuar nga zyra kompetente e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor
- Leje drejtimin e lëshuar nga dega e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor
- Kontrata e punes

Ne rastin kur mjetet janë me qera nuk është kusht që shoferi të jetë në listpagesen e shoqerisë.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Termet e references, sasitë, specifikimet teknike janë hartuar nga personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike caktuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Nr.413 Prot., date 28.03.2023.

Ato janë si me poshte:

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Emertimi	Sasia
1	Asfalto Beton	2,888 ton
2	Bitum per sperkatje	21,848 kg

Specifikimi i Materialeve:

Asfalto beton

- Ne perzierjen e gateshme nuk lejohet te kete kokrriza te pambuluara me bitum.
- Dozimi i perberesve te asfaltit te jete me saktesi +/- 3% per materialin guror dhe +/- 1.5% per bitumin e pluhurin.
- Temperatura e mases te asfalto-betonit ne vend, ne momentin e hedhjes te jete jo me pak se 150 grade celsius.
- Materiali i gurrit qe perdoret per asfalto-betoni te jene ne marke me te vogel se 800kg/cm2.
- Sasia e kokrrizave te dobeta te cakullit ne perzierje te asfalto-betonit te mos kaloje 10%.
- Thithja e ujit te jete 1-3% rezistenca ne shtypje e asfalto-betonit te jete jo me pak se 25 kg/m2
- Koeficienti i qendreses kundrejt nxehtesise mos jete me shume se 2.5%.
- Koeficienti i qendreses ndaj ujit te jete 0.5 %.

Shënime

Furnizimi do te kryhet sipas nevojave te N.Sh.P me automjetin e shoqerise.

Afatet e levrimit:

Afatet e levrimit:12 muaj nga data e lidhjes se marreveshjes kuader.

Specifikimet teknike jane hartuar pas verifikimeve te kryera ne lidhje me nevojat per asfalto beton e bitum per sperkatje qe ka ndermarrja duke u bazuar edhe ne pervojat e viteve te meparshme.

Specifikimet teknike jane hartuar ne perputhje me nenin 36, te LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi :

Kjo kontrate ka per qellim realizimin e furnizimit me asfalto beton e bitum per sperkatje.

Kontraktuesi duhet te furnizoje me mallra ne perputhje me standartet e kerkuara dhe specifikimet teknike me shpenzimet e tij deri ne dorezimin ne vendet e percaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Afati

12 muaj nga data e lidhjes se mareveshjes kuader.

Specifikimet teknike jane hartuar ne perputhje me nenin 36, te LPP, si dhe te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Materialet jane kerkuar sipas sasive dhe nevojane efektive per te permbushur nevojat e ndermarrjes ne menyre te plote per realizimin e sherbimeve ne interes te komunitetit. Materialet jane specifikuar ne menyre te tille qe te jene te pershtatshme per te qene sa me rezistente dhe te dukshme ne rruge, gjithashtu qe do te permbushhin te gjitha standartet rrugore.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT